



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr 13481 prot.

Shkodër, me 24.06.2024

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin **PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË V.K.B. NR. 55 DATË 29.12.2023 “ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2024-2026 TË BASHKISË SHKODËR” I NDRYSHUAR.**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z / KRYETAR

Ont BEJLERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____.2024

PROJEKT-VENDIMI

Nr. _____, datë _____.2024

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË V.K.B. NR. 55 DATË 29.12.2023 “ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2024-2026 TË BASHKISË SHKODËR” I NDRYSHUAR.

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot me datë ____/____/2024, në mbështetje të nenit 27, neni 54 gërma “dh” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr. 97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 24.01.2024; ligjit nr 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, VKB nr 55 datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër” të ndryshuar; shkresës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 3597/12 datë 04.06.2024 “Mbi çeljen e fondit për investimet e kërkuara nga ju”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 307 datë 22.05.2024 “Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore” sipas materialit të përgatitur nga administrata e bashkisë dhe me propozim të Kryetarit të bashkisë Shkodër,

VENDOSI

1. Miratimin e shtesës së planit të Buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektet kapitale të Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit AMTP dhe Njesisë së Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile si më poshtë:

-Investimi me objekt: Kanali kryesor Mjedë KU-22 Bëltojë. Trush; Kanali kryesor Mjedë ; KU-23 Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-23-1 Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-22-1; Bëltojë, Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-22-2 Bëltojë, Trush për zbatim të investimit në vlerën 75,560,770 lekë me TVSH në zërin Investime, prej të cilave shuma 32,400,000 lekë për vitin 2024, shuma 43,160,770 lekë për vitin 2025.

-Investimi me objekt: Vepra e marrjes Spathar KU-10 Vukatanë-Kuç për zbatim të investimit në vlerën 51.853.884 lekë me TVSH në zërin Investime, prej të cilave shuma

15,000,000 lekë për vitin 2024, shuma 16,000,000 lekë për vitin 2025, shuma 20,853,884 lekë për vitin 2026.

-Investimi me objekt: "Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës" për zbatim të investimit në vlerën 12.162,007 lekë.

2. Miratimin e përdorimit të fondit rezervë të Bashkisë Shkodër, në programin 4910, artikulli 609, miratuar nga V.K.B. nr. 55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër" në vlerën **3,440,001 lekë**, për mbulimin e kostove të mbikqyrjes dhe kolaudimit të projekteve të zbatimit, të financuara me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 226 date 09.04.2024 "Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 307 dt 22.05.2024 "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore" si më poshtë:

lekë				
Nr.	Nr. Programi	Aktiviteti/emertimi	Art. 231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	Institucioni likuidues
1	4240 Menaxhimi i Infrastruktures së Kullimit dhe Ujitjes	P4240 Q1 O1 A7- Kanali kryesor Mjedë KU-22 Bëltojë, Trush Kanali kryesor Mjedë KU-23 Trush Kanali kryesor Mjedë KU-23- 1 Trush Kanali kryesor Mjedë KU-22- 1 Bëltojë, Trush Kanali kryesor Mjedë KU-22- 2 Bëltojë, Trush <i>A1. Mbikqyrje</i>	1,706,436	Bashkia Shkodër
2		P4240 Q1 O1 A7- Kanali kryesor Mjedë KU-22 Bëltojë, Trush Kanali kryesor Mjedë KU-23 Trush Kanali kryesor Mjedë KU-23- 1 Trush Kanali kryesor Mjedë KU-22- 1 Bëltojë, Trush Kanali kryesor Mjedë KU-22- 2 Bëltojë, Trush <i>A2- Kolaudim</i>	50,400	Bashkia Shkodër
3		P4240 Q1 O1 A8 - Vepra e marrjes Spathar KU-10 Vukatanë-Kuç <i>A1- Mbikqyrje</i>	1.300.855	Bashkia Shkodër

4		P4240 Q1 O1 A8 Vepra e marrjes Spathar KU-10 Vukatanë-Kuç <i>A2 - Kolaudim</i>	48,000	Bashkia Shkodër
5	03280 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	P3280 Q1 O1 A6 - "Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës" <i>A1- Mbikqyrje</i>	307.699	Bashkia Shkodër
6		P3280 Q1 O1 A6 - "Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës" <i>A2. Kolaudim</i>	26.611	Bashkia Shkodër
TOTALI			3,440,001	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Zv. Kryetar

Drejtorja e Zhvillimit
të Qëndrueshëm Ekonomik

Orion Byleri

Benet Beci

Drejtorja e Përgjithshme
e Menaxhimit Financiar

Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural
dhe Trajtimit AMTP

Arbë Haxho

Solida MALA

Drejtorja e Financës

Njësia e Emergjencave dhe e Mbrojtjes
Civile

Blerta Gjocaj

Loti Hulumetaj

Drejtorja e Analizës dhe
Programimit Buxhetor

Drejtorja Juridike

[Signature]

Bilens Legjio



Nr. _____ Prot.

Shkodër, më _____, 2024

RELACION

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË V.K.B. NR. 55 DATË 29.12.2023 “ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2024-2026 TË BASHKISË SHKODËR” I NDRYSHUAR.

Në përgjigje të thirrjes për aplikim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas shkresës nr. 368 Prot. datë 15.01.2024, “Mbi financimin e objekteve të ujitjes dhe kullimit të bashkive” ku kërkohet dërgimi i propozimeve mbi prioritetet e ndërhyrjeve në objektet e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe dërguar për financim propozimet dhe projektet e zbatimit për ndërhyrje në infrastrukturën e ujitjes.

Nga ana e Bashkisë Shkodër, me nr. 1762 Prot. datë 29.01.2024, janë dërguar pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural aplikimet për 18 projekte zbatimi në infrastrukturën e ujitjes.

Me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 226 date 09.04.2024 “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes”, Bashkia Shkodër ka përfituar financimin e 6 (gjashtë) projekteve në vlerën **127,414,654** leke, vlerë financimi kjo e shpërndarë në tre vite.

Miratimi i financimit të këtyre projekteve i jep mundësinë Bashkisë Shkodër që me anë të zbatimit të tyre të përmirësojë ndjeshëm infrastrukturën e ujitjes në territorin e saj, infrastrukturë kjo e amortizuar ndër vite e cila ka nevojë për ndërhyrje kapitale të cilat janë të pamundura me buxhetin e vetë bashkisë.

Bashkia Shkodër ka aplikuar në thirrjen e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për aplikim për projekte për “ Parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore”.

Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projektit. “**Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës**” kjo bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 307 dt 22.05.2024 “ Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve sipas njësive të vetqeverisjes vendore” vlera e plotë e investimit është **12,162,007** lekë.

Investimet e miratuara, sipas procedurave standarte të zbatimit bazuar në ligjin nr 8402/1998 “ Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, kërkojnë mbikqyrje dhe kolaudim të punimeve, kosto e cila nuk parashikohet në vlerën e financimit të projekteve të miratuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 226 date 09.04.2024 Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi “ Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 307 datë

22.05.2024 – Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve sipas njësive të vetqeverisjes vendore”

Për këtë arsye referuar bazës ligjore: ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar , ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ; ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar ; ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr. 97/2023 “ Për Buxhetin e vitit 2024” ; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “ Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 24.01.2024”, ligjit nr 24/2017 “ Për administrimn e ujitjes dhe të kullimit”, VKB nr 55 datë 29.12.2023 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar ; kërkojmë nga ana juaj mundësinë e miratimit të përdorimit të fondit rezervë të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër për mbulimin e kostove të mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve për projektet e sipërpërmendura.

Kostoja e mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve për projektet në fjalë, bazuar në VKM nr. 354/2016 “ për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim. mbikqyrje dhe kolaudim, është llogaritur të jetë në vlerën 3.440.001 lekë.

Burimi i financimit do jetë nga fondi rezerve ne programin 4910, artikulli 609 në vlerën **3,440,001 lekë.**

lekë

Nr.	Nr. Programi	Aktiviteti/emertimi	Art. 23 i Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	Institucioni likuidues
1	4240 Menaxhimi i Infrastruktues së Kullimit dhe Ujitjes	P4240 Q1 O1 A7- Kanali kryesor Mjedë KU-22 Bëltojë, Trush Kanali kryesor Mjedë KU-23 Trush Kanali kryesor Mjedë KU-23-1 Trush Kanali kryesor Mjedë KU-22-1 Bëltojë, Trush Kanali kryesor Mjedë KU-22-2 Bëltojë, Trush <i>A1. Mbikqyrje</i>	1.706,436	Bashkia Shkodër

2		P4240 Q1 O1 A7- Kanali kryesor Mjedë KU-22 Bëltojë, Trush Kanali kryesor Mjedë KU-23 Trush Kanali kryesor Mjedë KU-23-1 Trush Kanali kryesor Mjedë KU-22-1 Bëltojë, Trush Kanali kryesor Mjedë KU-22-2 Bëltojë, Trush <i>A2 - Kolaudim</i>	50,400	Bashkia Shkodër
3		P4240 Q1 O1 A8 - Vepra e marrjes Spathar KU-10 Vukatanë-Kuç <i>A1- Mbikqyrje</i>	1,300,855	Bashkia Shkodër
4		P4240 Q1 O1 A8 Vepra e marrjes Spathar KU-10 Vukatanë-Kuç <i>A2 - Kolaudim</i>	48,000	Bashkia Shkodër
5	03280 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	P3280 Q1 O1 A6 - "Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës" <i>A1- Mbikqyrje</i>	307,699	Bashkia Shkodër
6		P3280 Q1 O1 A6 - "Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës" <i>A2. Kolaudim</i>	26,611	Bashkia Shkodër
TOTALI			3,440,001	

Duke ju falenderuar!



KRYETAR
Benet BECI

Drejtoria e Zhvillimit
të Qëndrueshëm Ekonomik

Njësia e Emergjencave dhe e Mbrojtjes
Civile

Drejtor

Përgjegjës

Bekim Mema

Kolë Ndrevashaj